



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Nr. 25/2013
Datë: 09/09/2013

Në mbështetje të nenit 93, pragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-189 (GZRK Nr.82 i datës 21 Tetor 2010) për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011), nenit 14, pragrafi 3, nenit 53, paragrafi 1, dhe 2, nenin 129, paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233 (GZRK Nr.85/2010), Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/57, të datës 13.03.2009 për vënien nën mbrojtje të monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë "Shpella e Gadimes" në Gadime të Ulët të Komunës së Lypjanit, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr:

V E N D I M

Për mbylljen dhe ndalimin e përkohshëm të të gjitha aktiviteteve në Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" në Gadime të Ulët – Komuna e Lypjanit.

Vendimi merret si masë e përgjithshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë nga veprimtaritë e palejuara të cilat po rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.

Në një afat të arsyershëm kohor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të ndërmarrë masat e nevojshme për themelimin e Drejtorisë për Administrimin e Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes".

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Inspektorati Mjedisor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Ministrit - MMPH;
- Zyrës së Sekretarit të Përhershëm – MMPH;
- Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv - AMMK;
- Inspektpratit Mjedisor – MMPH;
- Komunal të Lypjanit;
- Policisë së Kosovës;
- Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

Dardan GASHI,

Minister i MMPH-së